



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 06.04.2023

Nr: 49

Ora: 13:30

**VENDIM**

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 47, DATË 05.04.2023 TË DEPOZITUAR NGA Z. VEBI TAHIR HANA**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 06.04.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Z. Vebi Tahir Hana;

**OBJEKT:**

- Kundërshtimi i i vendimit nr. 19, datë 30.03.2023 i KZAZ nr. 53, Prrenjas
- Ndryshimi i vendimit duke vendosur regjistrimin e z. Vebi Tahir Hana, si kandidat për kryetar të bashkisë Prrenjas, i propozuar nga "Partia Uniteti Kombëtar", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, pika 1, shkronja “c”, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

#### **VËREN:**

Z. Vebi Tahir Hana ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 47 regj., datë 05.04.2023.

Në mbledhjen e datës 06.04.2023, ora 13:30, pas relatimit të z. Ilirjan Rusmali, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 47 nuk i plotësonte kërkesat e nenit 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, konkretisht pikën 1, shkronjën “c” të nenit 130, pasi është paraqitur në datën 05.04.2023 pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërkohë që vendimi objekt kundërshtimi është marrë nga KZAZ-ja nr. 53 Prrenjas, në datën 30.03.2023. Pra, z. Hana e ka depozituar kërkesën ankimore jashtë afatit.

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

#### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 47, datë 05.04.2023, të paraqitur nga Z. Vebi Tahir Hana, për shkak se është paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimit.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>